

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Mirëmbajtja e koshave të mbetjeve.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **39224340-3.**

VLERA E FONDIT LIMIT: **2,523,720** (dymilion e pesëqindënjëzetetremijë e shtatëqindënjëzetë) **Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor: **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për ekzekutimin e kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente: Kategoria NS-4, Klasifikimi A, Emërtimi “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*

c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës” dhe nenin 41, pika 4, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Në bazë të liçencës profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që prokurohet dhe pikat e kërkuara të licensës janë përcaktuar nga vlera e shërbimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e shërbimeve që do të kryhen sipas zërave të preventivit. Kategoria NS-4, Klasifikimi A, Emërtimi “Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese” është përcaktuar bazuar në objektin e prokurimit që është “Mirëmbajtja e koshave të mbetjeve”. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 000 000 lekë, është zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” që i përgjigjet kësaj vlere. Zwrat e preventivit të shërbimeve përfshijnë ndërhyrje tipike të rifiniturës dhe përpunimit të materialeve metalike, të cilat kërkojnë kompetencë të specializuar dhe përputhshmëri me standardet e ndërtimit. Furnizimi dhe vendosja e llamarinës xingat 0.8 mm përbën një proces që kërkon përpunim të saktë, prerje, fiksime dhe trajtim të sipërfaqes për të garantuar rezistencë ndaj kushteve atmosferike dhe jetëgjatësi të elementëve. Po kështu, furnizimi dhe montimi i rrotave për kazanët metalikë 1,100 litra përfshin ndërhyrje në struktura metalike ekzistuese, ku kërkohet saktësi teknike dhe siguri funksionale për të përballuar ngarkesat gjatë përdorimit. Ndërkohë, lyerja me bojë vaji për sipërfaqe metalike është një proces rifiniture që kërkon përgatitje të duhur të sipërfaqes, aplikim profesional dhe përdorim materialesh cilësore për të siguruar mbrojtje ndaj korrozionit dhe konsumimit. Të gjithë këta zëra bien brenda fushës së veprimtarisë së liçencës NS-4, pasi lidhen drejtpërdrejt me rifinitura teknike ndërtuese dhe trajtim të materialeve metalike. Për rrjedhojë, kërkesa për paraqitjen e kësaj liçence garanton që operatori ekonomik disponon aftësitë teknike, pajisjet dhe personelin e kualifikuar për realizimin korrekt dhe të sigurt të këtyre punimeve, duke siguruar cilësi dhe qëndrueshmëri në zbatim.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP të ndryshuar, nenin 43, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar” si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se ”4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkojnë operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”.

Në nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të

shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”, nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit.

Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar.

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e shërbimeve të ngjashme me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- bojaxhi 1 (një)
- saldator 1 (një)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

- Kontratë Individuale të Punës (të vlefshme)
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme), të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi të njohur nga Republika e Shqipërisë, Institucione Shtetërore ose organizma të akredituar për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.....Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”. Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me natyrën e shërbimit të mirëmbajtjes së koshave të mbetjeve, e cila përfshin ndërhyrje të vazhdueshme në elementë metalikë dhe procese rifiniture që kërkojnë aftësi të specializuara. Prania e një bojaxhiu është e domosdoshme për realizimin korrekt të proceseve të lyerjes me bojë vaji për sipërfaqe metalike, duke përfshirë përgatitjen e sipërfaqeve, trajtimin kundër korrozionit dhe aplikimin profesional të shtresave mbrojtëse, çka ndikon drejtpërdrejt në rritjen e jetëgjatësisë dhe ruajtjen e kushteve higjieno-sanitare të koshave. Nga ana tjetër, kërkesa për një saldator është e lidhur me nevojën për riparime strukturore të elementëve metalikë, si riparimi i trupit të kazanëve, fiksimi i pjesëve të dëmtuara apo zëvendësimi i komponentëve si rrotat dhe mbajtëset, procese të cilat kërkojnë ndërhyrje të sigurt dhe profesionale për të garantuar qëndrueshmërinë mekanike dhe funksionalitetin e tyre në përdorim të përditshëm. Vetëdeklarimi në fazën fillestare lehtëson pjesëmarrjen në procedurë, ndërsa kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit provues nga operatori i renditur i pari siguron verifikimin real të kapaciteteve njerëzore dhe përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi mbi punësimin dhe sigurinë në punë. Në këtë mënyrë, kriteri garanton që operatori ekonomik disponon personel të kualifikuar dhe të certifikuar, duke minimizuar rreziqet teknike dhe duke siguruar cilësi, siguri dhe qëndrueshmëri në realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 10 (dhjetë) persona.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

Listëpagesës sipas formularit standart për sigurimet për muajin shkurt 2026.

Vërtetim nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për muajin shkurt 2026.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e

nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.....Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 41, pika 4/ b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpërndarje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listëpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: Nga përllogaritjet e volumit të punës rezulton se totali i ditëve të punës individuale është rreth 330–400 ditë pune, të shpërndara në proceset kryesore si përpunimi dhe montimi i llamarinës, saldimit, operacionet në konstruksione metalike, montimi i rrotave dhe ljerja e sipërfaqeve metalike. Në kushte normale, një punonjës realizon rreth 22–24 ditë pune efektive në muaj, por duke qenë se kemi një afat 30 ditor kalendarik (që në praktikë përfshin edhe ditë jo plotësisht produktive, ndërprerje, kohë logjistike dhe procese teknologjike), koha reale efektive e punës mbetet e kufizuar. Nëse marrim një mesatare prej 26 ditësh efektive pune për person gjatë këtij afati, atëherë kapaciteti i një punonjësi është rreth 26 ditë pune. Për të realizuar një volum prej minimalisht 330–400 ditë pune, kërkohet: $330-400 \text{ ditë pune} / 26 \text{ ditë} \approx 12-15$ punonjës (në kushte ideale lineare). Megjithatë, duke konsideruar organizimin paralel të proceseve, përdorimin e ekipeve të kombinuara (p.sh. saldator + ndihmës, bojaxhi + ndihmës), si dhe optimizimin e flukseve të punës, ky numër mund të reduktohet në mënyrë realiste në një minimum funksional prej 10 punonjësish. Ky është një prag minimal që lejon shpërndarjen e punës në disa fronte njëkohësisht, si p.sh. një ekip për saldimit dhe konstruksione metalike, një ekip për montim dhe zëvendësim pjesësh, dhe një ekip për përgatitje dhe ljerje. Një numër më i vogël punonjësish do të krijonte ngarkesë të lartë individuale, vonesa në zinxhirin e proceseve (sidomos në ndërvarësinë saldimit–ljerje), si dhe pamundësi për të respektuar afatin 30 ditor. Për rrjedhojë, vendosja e kriterit për minimum 10 punonjës është një kërkesë e arsyeshme dhe proporcionale, që garanton kapacitet të mjaftueshëm për realizimin në kohë, me cilësi dhe në përputhje me standardet teknike të të gjithë zërave të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Kamion vetëshkarkues me vinc kapacitet mbajtës (mbi 5 ton)	1 copë	Pronësi ose me qira
Saldatriçe	1 copë	Pronësi ose me qira
Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qira
Pajisje prerëse metali	1 copë	Pronësi ose me qira
Fikëse zjarri	5 copë	Pronësi ose me qira
Maska saldimi	5 copë	Pronësi ose me qira

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje, pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, dokumentacionin provues si më poshtë:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit;
- leje qarkullimi;
- çertifikaten e kontrollit teknik;
- siguracionin e mjetit.

b) Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e tij;
- leje qarkullimi;
- çertifikatën e kontrollit teknik,
- siguracionin e mjetit.

Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës që prokurohet dhe afati i saj.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Mjetet dhe pajisjet teknike e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedura të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” dhe nenin 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është përcaktuar duke u bazuar në zërat e preventivit dhe specifikimeve teknike. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset sipas zërave përkatës të preventivit. Përcaktimi i pajisjeve dhe makinerive është bërë duke marrë në konsideratë volumet e shërbimeve për secilin zë si dhe hapësirat fizike rreth objektit, mundësive të manovrimit me mjete, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes, Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se shërbimet do të realizohen me cilësi.

Realizimi i zërave të parashikuar kërkon përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve specifike që garantojnë efikasitet, siguri dhe cilësi në punë. Kamioni vetëshkarkues me vinç me kapacitet mbi 5 ton është i nevojshëm për transportin e materialeve metalike si llamarinat, për zhvendosjen e kazanëve metalikë 1,100 litra dhe për ngarkim-shkarkimin e tyre në terren, duke mundësuar operacione të shpejta dhe të sigurta pa dëmtime strukturore. Pajisja me saldatriçe dhe gjenerator është e lidhur drejtpërdrejt me proceset e saldimit dhe riparimit të elementëve metalikë, sidomos në kushte terreni ku mungon furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike, ndërsa pajisjet prerëse të metalit janë të domosdoshme për përpunimin, përshtatjen dhe zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara, duke siguruar saktësi teknike dhe cilësi në ndërhyrje.

Nga ana tjetër, pajisjet e sigurisë si fikëset e zjarrit dhe maskat e saldimit lidhen me kërkesat e detyrueshme të sigurisë në punë, duke qenë se proceset e saldimit, prerjes dhe përpunimit të metalit paraqesin rrezik të shtuar për zjarr dhe dëmtime fizike. Kërkesa për disponimin e këtyre pajisjeve në numër të mjaftueshëm garanton mbrojtjen e punonjësve dhe përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Mundësia për t’i disponuar këto mjete në pronësi ose me qira rrit konkurrencën dhe aksesin në procedurë, ndërsa kërkesa për dokumentacion provues, përfshirë regjistrimin, kontrollin teknik, siguracionin dhe kontratat përkatëse, siguron që mjetet janë funksionale, të ligjshme dhe të disponueshme gjatë gjithë periudhës së kontratës. Po ashtu, kërkesa që këto mjete të mos jenë të angazhuara në kontrata të tjera garanton dedikimin e plotë të kapaciteteve teknike për realizimin e kësaj kontrate brenda afateve të përcaktuara. Në këtë mënyrë, kriteri siguron që operatori ekonomik ka kapacitetet e nevojshme logjistike dhe teknike për të përballuar volumin e punimeve,

duke minimizuar rreziqet operationale dhe duke garantuar realizim cilësor dhe në kohë të shërbimit.

2.3.5 Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se shërbimet, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

- *Certifikatë e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015;*
- *Certifikatë e sistemit të menaxhimit të mjedisit ISO 14001:2015;*
- *Certifikatë per menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001-2018*

Në rastet e bashkimit ekonomik të operatorëve, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë përkatësisht Certifikatën ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Kontatës së Bashkëpunimit.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale”

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”, nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lid, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit”.

Kërkesa për certifikimin sipas ISO 9001:2015 siguron që operatori ekonomik disponon një sistem të strukturuar të menaxhimit të cilësisë, duke garantuar planifikim, kontroll dhe përmirësim të vazhdueshëm të proceseve si përpunimi i materialeve metalike, montimi dhe lyerja, çka ndikon drejtpërdrejt në jetëgjatësinë dhe funksionalitetin e koshave. Certifikimi sipas ISO 14001:2015 është i domosdoshëm duke qenë se aktivitetet përfshijnë përdorimin e materialeve si bojëra, vajra dhe procese që mund të gjenerojnë mbetje apo ndotje, ndaj kërkohet menaxhim i kontrolluar i ndikimit mjedisor, në përputhje me standardet dhe legjislacionin në fuqi. Ndërkohë, ISO 45001:2018 lidhet drejtpërdrejt me sigurinë dhe shëndetin në punë, duke qenë se proceset e saldimit, prerjes së metalit dhe transportit të elementëve të rëndë paraqesin rreziqe të

konsiderueshme për punonjësit, ndaj është e nevojshme që operatori të ketë sisteme të konsoliduara për identifikimin dhe menaxhimin e këtyre rreziqeve.

Kërkesa që certifikatat të jenë të lëshuara nga organe të akredituara garanton besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre, duke siguruar që operatori ekonomik është audituar dhe përputhet realisht me standardet ndërkombëtare.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	FV llamarinë xingat 0.8mm	kg	1,740
2	Elektroda	kg	500
3	FV rrota për kazanët metalikë 1.100 litra	copë	820
4	Lyerje me bojë vaji për sipërfaqe metalike	m ²	957
5	Punëtori e specializuar konstruksione metalike	op	380

Furnizim dhe vendosje llamarine të xingatuar: Furnizim dhe përdorim i llamarinës së xingatuar me trashësi 0.8 mm, e përshtatshme për konstruksione metalike të ekspozuara ndaj kushteve atmosferike. Prerja, formësimi dhe saldimit i llamarinës sipas dimensioneve ekzistuese të kazanëve metalikë. Llamarina duhet të jetë rezistente ndaj korrozionit dhe dëmtimeve mekanike.

Elektroda për saldim: Përdorimi i elektrodave të përshtatshme për konstruksione metalike, në përputhje me standardet teknike të saldimit. Saldime të plota, të njëtrajtshme dhe të qëndrueshme, pa çarje apo defekte strukturore.

Furnizim dhe montim rrotash për kazanë metalikë 1.100 litra: Furnizim dhe zëvendësim i rrotave për kazanë metalikë me kapacitet 1.100 litra, të përshtatshme për ngarkesa të rënda. Rrotat duhet të jenë rezistente ndaj konsumimit, me bosht metalik dhe material cilësor (gome ose poliuretan). Montimi duhet të garantojë stabilitet, lëvizshmëri dhe siguri gjatë përdorimit.

Lyerje me bojë vaji për sipërfaqe metalike: Pastrim paraprak i sipërfaqeve metalike nga ndryshku, papastërtitë dhe mbetjet e saldimit. Aplikim i bojës së vajit për metal, rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe korrozionit. Lyerja të kryhet në mënyrë uniforme, duke garantuar mbrojtje dhe estetikë të përshtatshme.

Punëtori e specializuar për konstruksione metalike: Të gjitha punimet do të kryhen në punëtori të specializuar për konstruksione metalike, e pajisur me mjetet dhe makineritë e nevojshme. Personeli

duhet të jetë i kualifikuar dhe me përvojë në punime metalike, saldim dhe riparime strukturore. Respektim i rregullave të sigurisë teknike dhe standardeve të punës.

Argumentimi: Sa i përket furnizimit dhe vendosjes së llamarinës së xingatuar me trashësi 0.8 mm, kjo kërkesë është teknikisht e justifikuar duke pasur parasysh se kazanët metalikë të mbetjeve janë të ekspozuar në mënyrë të vazhdueshme ndaj kushteve atmosferike, lagështisë, agjentëve kimikë dhe ngarkesave mekanike. Lllarina e xingatuar, për shkak të trajtimit të saj me shtresë mbrojtëse zinku, ofron një rezistencë të lartë ndaj korrozionit dhe oksidimit, duke reduktuar ndjeshëm kostot e mirëmbajtjes në afatgjatë dhe duke rritur jetëgjatësinë e strukturës metalike. Trashësia 0.8 mm përfaqëson një balancë optimale midis qëndrueshmërisë strukturore dhe lehtësisë në përpunim, duke siguruar që elementi të jetë mjaftueshëm rezistent ndaj deformimeve mekanike, por njëkohësisht i përshtatshëm për prerje, formësim dhe saldim sipas dimensioneve ekzistuese të kazanëve. Ky specifikim është në përputhje me praktikën inxhinierike dhe standardet industriale për konstruksione të lehta metalike të ekspozuara.

Përdorimi i elektrodave për saldim në sasinë e përcaktuar lidhet drejtpërdrejt me procesin e rikonstruksionit dhe riparimit të strukturës metalike të kazanëve. Elektrodët duhet të jenë të përshtatshme për llojin e çelikut të përdorur dhe të përmbushin standardet teknike të saldimit, duke garantuar lidhje të forta dhe të qëndrueshme strukturore. Kërkesa për saldime të plota, homogjene dhe pa defekte si çarje, porozitete apo përfshirje skorjesh është thelbësore për të shmangur dobësimin e strukturës dhe për të garantuar sigurinë gjatë përdorimit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh ngarkesat dinamike dhe statike që përballojnë kazanët gjatë përdorimit të përditshëm dhe gjatë proceseve të zbrazjes mekanike nga mjetet e grumbullimit të mbetjeve.

Në lidhje me furnizimin dhe montimin e rrotave për kazanë metalikë me kapacitet 1.100 litra, ky specifikim është i lidhur ngushtë me funksionalitetin dhe mobilitetin e pajisjeve. Kazanët e këtij kapaciteti përdoren për volum të konsiderueshëm mbetjesh dhe për rrjedhojë i nënshtrohen ngarkesave të larta. Për këtë arsye, rrotat duhet të jenë të dimensionuara dhe të ndërtuara për të përballuar peshë të madhe, goditje të vazhdueshme dhe konsumim nga përdorimi intensiv në ambiente urbane. Përdorimi i materialeve cilësore si goma industriale ose poliuretani, në kombinim me bosht metalik rezistent, garanton amortizim të goditjeve, qëndrueshmëri në kohë dhe lëvizshmëri të sigurt në sipërfaqe të ndryshme. Montimi korrekt i tyre është një element kritik për stabilitetin e kazanëve, duke parandaluar rrezikun e aksidenteve apo dëmtimeve gjatë përdorimit nga qytetarët dhe shërbimet e pastrimit.

Procesi i lyerjes me bojë vaji për sipërfaqe metalike është një tjetër komponent teknik i domosdoshëm në këtë objekt prokurimi, pasi ai lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e strukturës metalike nga degradimi. Pastrimi paraprak i sipërfaqeve nga ndryshku, papastërtitë dhe mbetjet e saldimit është një kërkesë teknike bazë për të siguruar aderencë optimale të bojës dhe për të shmangur zhvillimin e korrozionit nën shtresën mbrojtëse. Aplikimi i bojës së vajit me karakteristika rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe agjentëve korrozivë krijon një barrierë mbrojtëse që rrit ndjeshëm jetëgjatësinë e kazanëve. Një lyerje uniforme dhe profesionale jo vetëm që përmirëson aspektin estetik, por gjithashtu siguron mbulim të plotë të sipërfaqes, duke eliminuar pikat e dobëta ku mund të fillojë degradimi.

Përfshirja e punëtorisë së specializuar për konstruksione metalike si një zë i veçantë në specifikimet teknike lidhet me nevojën për të garantuar që të gjitha proceset e përpunimit, riparimit

dhe montimit të kryhen në kushte të kontrolluara dhe me standarde profesionale. Një punëtori e tillë duhet të jetë e pajisur me makineri dhe mjete të specializuara për prerje, formësim dhe saldim, si dhe me personel të kualifikuar që zotëron njohuritë dhe eksperiencën e nevojshme në fushën e konstruksioneve metalike. Kjo kërkesë nuk është kufizuese, por synon të sigurojë cilësi të lartë të punimeve dhe respektim të rregullave të sigurisë teknike, duke minimizuar rrezikun e defekteve dhe duke garantuar përputhshmëri me standardet profesionale dhe ligjore të punës.

Specifikimet teknike janë funksionale dhe të orientuara drejt performancës, pasi ato synojnë të garantojnë që shërbimi i mirëmbajtjes së kazanëve të realizohet në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme në kohë. Ato vendosin standarde minimale teknike që çdo operator duhet të përmbushë për të siguruar cilësinë e shërbimit publik.

Afatet e ekzekutimit: 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga lidhja e kontratës.

Afati i përcaktuar reflekton një vlerësim realist të volumit të punimeve dhe të kapaciteteve që duhet të disponojë një operator ekonomik i kualifikuar. Një subjekt që operon në fushën e konstruksioneve metalike dhe mirëmbajtjes industriale pritet të ketë në dispozicion burimet njerëzore, pajisjet dhe infrastrukturën e nevojshme për të përballuar paralelisht disa procese pune, duke optimizuar kohën përmes organizimit në linja pune apo faza të ndryshme të ndërhyrjes. Kjo përfshin mundësinë e përpunimit të elementeve metalike në punëtori, ndërkohë që në terren kryhen procese të tjera si montimi apo zëvendësimi i komponentëve, duke reduktuar kohën totale të realizimit. Një afat i tillë është i domosdoshëm për të shmangur degradimin e mëtejshëm të kazanëve dhe për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit publik pa ndërprerje. Zgjatja e afatit përtej një periudhe të arsyeshme do të sillte pasoja negative në menaxhimin e mbetjeve, duke rritur rrezikun për probleme higjieno-sanitare, dëmtime të mëtejshme të pajisjeve dhe kosto shtesë për autoritetin kontraktor. Për këtë arsye, ndërhyrja brenda një periudhe 30-ditore konsiderohet si një standard i balancuar midis urgjencës së nevojës dhe realizueshmërisë teknike.

Termet e referencës

1. Objekt i kontratës

Objekti i kontratës është furnizimi, instalimi, mirëmbajtja dhe trajtimi i elementeve metalike të koshave dhe kazanëve të mbetjeve, duke përfshirë:

- Furnizim dhe vendosje llamarine të xingatuar
- Elektroda për saldim
- Furnizim dhe montim rrotash për kazanë metalikë
- Lyerje me bojë vaji për sipërfaqe metalike
- Punëtori e specializuar për konstruksione metalike

Qëllimi është sigurimi i funksionimit të qëndrueshëm, sigurisë dhe estetikës së koshave dhe strukturave metalike në territorin e përcaktuar nga AK.

2. Përshkrimi i detyrave dhe shërbimeve

2.1. Furnizim dhe vendosje llamarine xingat 0.8 mm

Operatori ekonomik do të furnizojë llamarinë e xingatuar me trashësi të përshtatshme për konstruksione metalike dhe do të kryejë prerjen, formësimin dhe saldimin e saj sipas dimensioneve të strukturave ekzistuese. Llamarina duhet të jetë rezistente ndaj korrozionit dhe dëmtimeve mekanike.

2.2. Elektroda për saldim

Përdorimi i elektrodave të certifikuara dhe të përshtatshme për saldim strukturash metalike. Saldimet duhet të jenë të qëndrueshme, të njëtrajtshme, pa çarje apo defekte strukturore, për të garantuar sigurinë dhe qëndrueshmërinë e elementeve.

2.3. Furnizim dhe montim rrotash për kazanë metalikë

Operatori do të furnizojë dhe montojë rrotat për kazanë metalikë të kapacitetit të përcaktuar. Rrotat duhet të jenë rezistente ndaj konsumimit, me bosht metalik dhe material cilësor (gome ose poliuretan). Montimi duhet të garantojë stabilitet, lëvizshmëri dhe siguri gjatë përdorimit.

2.4. Lyerje me bojë vaji për sipërfaqe metalike

Pastrimi paraprak i sipërfaqeve nga ndryshku dhe papastërtitë, dhe aplikimi uniform i bojës së vajit të përshtatshme për metale, rezistente ndaj kushteve atmosferike dhe korrozionit. Lyerja duhet të sigurojë mbrojtje dhe estetikë të qëndrueshme.

2.5. Punëtori e specializuar për konstruksione metalike

Të gjitha punimet duhet të kryhen në punëtori të specializuar për konstruksione metalike, e pajisur me makineritë dhe mjetet e nevojshme. Stafi duhet të jetë i kualifikuar dhe me përvojë në përpunime metalike, saldim dhe riparime strukturore, duke respektuar standardet e sigurisë dhe punës.

3. Kapaciteti teknik dhe kërkesat profesionale

- Operatorët duhet të kenë përvojë të dëshmuar në punime metalike dhe mirëmbajtje strukturore.
- Stafi duhet të jetë i trajnuar dhe të posedojë certifikata për punë të specializuar me metale.
- Të disponojnë automjete dhe pajisje të nevojshme për transport, instalim dhe mirëmbajtje të elementeve metalike.

4. Siguria dhe standardet

- Shërbimet duhet të kryhen duke respektuar të gjitha normat e sigurisë në punë dhe rregulloret ligjore në fuqi.
- Materialet duhet të jenë të aprovuara për përdorim publik dhe të mos dëmtojnë mjedisin.

5. Frekuenca dhe mbikëqyrja

- Mbikëqyrja dhe mirëmbajtja periodike e elementeve metalike duhet të kryhet sipas afateve të përcaktuara nga AK.
- Operatorët duhet të dorëzojnë raporte të detajuara për gjendjen, ndërhyrjet dhe mirëmbajtjen e kryer.

6. Rezultati i pritur

- Koshat dhe strukturat metalike të funksionojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurt.
- Reduktim i dëmtimeve, konsumimit dhe korrozionit.
- Dokumentim i rregullt i punimeve dhe mirëmbajtjes për auditim nga AK.

Shpërndarja: Territori i Bashkisë Himarë.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: Ndrëmarrrja e Shërbimeve Publike Himarë

Termat e referencës të paraqitura për këtë procedurë prokurimi janë të ndërtuara mbi një bazë të qartë teknike dhe funksionale, duke reflektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë natyrën e objektit të kontratës, që është mirëmbajtja dhe rikthimi në funksionalitet optimal i koshave dhe kazanëve metalikë të mbetjeve në territorin e Bashkisë Himarë. Këto terma nuk përbëjnë thjesht një listë

përshkrimore të punimeve, por një strukturë të integruar kërkesash teknike dhe organizative që synojnë garantimin e cilësisë, sigurisë dhe qëndrueshmërisë së shërbimit publik në menaxhimin e mbetjeve urbane.

Objekti i kontratës është përcaktuar në mënyrë gjithëpërfshirëse duke përfshirë të gjithë ciklin e ndërhyrjes teknike mbi elementet metalike, që nga furnizimi i materialeve bazë, përpunimi dhe instalimi, deri te mirëmbajtja dhe trajtimi përfundimtar i tyre. Kjo qasje është teknikisht e domosdoshme, pasi siguron që operatori ekonomik të ketë përgjegjësi të plotë mbi cilësinë e çdo faze të procesit dhe shmang fragmentarizimin e shërbimit, i cili mund të çonte në mungesë koordinimi dhe ulje të standardeve të zbatimit. Përfshirja e të gjitha këtyre komponentëve në një kontratë të vetme garanton gjithashtu efikasitet ekonomik dhe kontroll më të mirë nga ana e autoritetit kontraktor.

Përshkrimi i detyrave dhe shërbimeve është i detajuar në mënyrë të tillë që çdo ndërhyrje teknike të jetë e qartë, e matshme dhe e verifikueshme. Furnizimi dhe vendosja e llamarinës së xingatuar me trashësi 0.8 mm përfaqëson një zgjidhje standarde inxhinierike për riparimin e strukturave metalike të ekspozuara ndaj kushteve atmosferike dhe faktorëve korrozivë. Kjo trashësi siguron një raport optimal midis rezistencës mekanike dhe lehtësisë së përpunimit, ndërkohë që shtresa e zinkut garanton mbrojtje të shtuar ndaj oksidimit. Proceset e prerjes, formësimit dhe saldimit sipas dimensioneve ekzistuese tregojnë se ndërhyrja është e orientuar drejt përshtatjes me strukturat reale në terren, duke shmangur zgjidhjet standarde të papërshtatshme.

Përdorimi i elektrodave të certifikuara për saldim është një kërkesë thelbësore për garantimin e integritetit strukturor të kazanëve. Saldimi është një nga proceset më kritike në rikonstruksionin e elementeve metalike, dhe cilësia e tij ndikon drejtpërdrejt në sigurinë dhe jetëgjatësinë e pajisjeve. Kërkesa për saldime pa defekte strukturore është në përputhje me standardet teknike të industrisë dhe synon eliminimin e rreziqeve që mund të lindin nga dobësimet në nyjet metalike.

Furnizimi dhe montimi i rrotave për kazanë metalikë është një komponent që lidhet me funksionalitetin praktik të pajisjeve në terren. Duke qenë se këta kazanë përdoren në kushte intensive dhe mbajnë ngarkesa të konsiderueshme, rrotat duhet të kenë karakteristika të larta rezistence ndaj konsumimit dhe deformimit. Përdorimi i materialeve si goma industriale ose poliuretani, së bashku me bosht metalik të fortë, garanton jo vetëm jetëgjatësi, por edhe siguri në lëvizje, duke reduktuar rrezikun e dëmtimeve apo aksidenteve gjatë përdorimit të përditshëm.

Procesi i lyerjes me bojë vaji për sipërfaqe metalike është një masë mbrojtëse dhe parandaluese ndaj degradimit të mëtejshëm të strukturave. Pastrimi paraprak i sipërfaqeve është teknikisht i domosdoshëm për të siguruar aderencë të plotë të bojës dhe për të shmangur zhvillimin e korrozionit nën shtresën mbrojtëse. Boja e vajit e përshtatshme për metal krijon një barrierë ndaj lagështisë dhe agjentëve atmosferikë, duke kontribuar në ruajtjen e integritetit strukturor dhe në përmirësimin e aspektit estetik të kazanëve, që është një element i rëndësishëm në hapësirat publike.

Kërkesa që punimet të kryhen në një punëtori të specializuar për konstruksione metalike është një element kyç për garantimin e cilësisë së zbatimit. Një mjedis i tillë ofron kushtet teknike dhe pajisjet e nevojshme për përpunim të saktë dhe të kontrolluar të materialeve, gjë që nuk mund të arrihet në kushte të improvizuara në terren. Gjithashtu, kjo kërkesë siguron që proceset e saldimit dhe përpunimit të kryhen nga personel i kualifikuar, duke respektuar standardet profesionale dhe rregullat e sigurisë në punë.

Përcaktimi i kapaciteteve teknike dhe kërkesave profesionale për operatorët ekonomikë është i lidhur drejtpërdrejt me kompleksitetin e punimeve. Kërkesa për përvojë të dëshmuar, staf të trajnuar dhe pajisje të përshtatshme nuk është kufizuese, por synon të garantojë që operatorët pjesëmarrës kanë aftësinë reale për të përmbushur kontratën sipas standardeve të kërkuara. Kjo është në përputhje me parimin e proporcionalitetit në prokurim publik, pasi kërkesat janë të lidhura ngushtë me natyrën e shërbimit.

Elementët që lidhen me sigurinë dhe standardet janë të domosdoshëm për të garantuar që ndërhyrjet teknike të mos krijojnë rreziqe për punonjësit, përdoruesit apo mjedisin. Respektimi i normave të sigurisë në punë dhe përdorimi i materialeve të aprovuara për përdorim publik janë kërkesa që burojnë jo vetëm nga praktika teknike, por edhe nga detyrimet ligjore në fuqi për mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit.

Frekuenca e mbikëqyrjes dhe kërkesa për raportim të detajuar krijojnë një mekanizëm kontrolli dhe transparence, i cili i mundëson autoritetit kontraktor të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e punimeve dhe gjendjen e infrastrukturës. Dokumentimi i rregullt i ndërhyrjeve është thelbësor për auditim, për planifikim të mirëmbajtjes së ardhshme dhe për vlerësimin e performancës së operatorit ekonomik.

Rezultatet e pritshme të përcaktuara në termat e referencës janë të lidhura drejtpërdrejt me objektivat funksionale të kontratës, duke synuar sigurimin e një infrastrukture të qëndrueshme, të sigurt dhe me jetëgjatësi të shtuar. Reduktimi i dëmtimeve dhe korrozionit përkthehet në ulje të kostove afatgjata dhe në përmirësim të cilësisë së shërbimit publik, ndërsa dokumentimi i rregullt garanton llogaridhënie dhe transparencë.

Në tërësi, këto terma reference janë të hartuara në përputhje me praktikat më të mira teknike dhe me parimet e prokurimit publik, duke qenë të qarta, të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe të nevojshme për arritjen e një rezultati cilësor në interes të komunitetit dhe të administrimit eficient të shërbimeve publike në territorin e Bashkisë Himarë.

NJËSIA E PROKURIMIT